




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Dpt. \_\_\_\_\_  
 Nr. i hau \_\_\_\_\_  
 sht. shprehja \_\_\_\_\_  
 Nr. pages \_\_\_\_\_

Nr. Prot \_\_\_\_\_  
 Br. Prot \_\_\_\_\_  
 Prot. No. 03-02/3505/18  
 Data \_\_\_\_\_  
 Datum 16.10.2018  
 Data \_\_\_\_\_

P - SHITJE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.10.2018, mori:

**V E N D I M**


**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2181/18, për zyrtarin e lartë z. Arian Imeri, Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë z. Arian Imeri, Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj dhe njëkohësisht Koordinator i Shitjes në Ndërmarrjen Publike Telekom i Kosovës Sh.A, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese është organizuar një takim me zyrtarin e lartë për të diskutuar lidhur me rastin.





Në bazë të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, ushtrimi i funksionit Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj dhe njëkohësisht Koordinator i Shitjes në Ndërmarrjen Publike Telekom i Kosovës Sh.A nuk paraqet konflikt të interesit.

Gjatë ushtrimit të funksionit publik eventualisht mund të paraqitet ndonjë ndonjë konflikt i interesit "rast për rast" mirëpo kjo situatë mund të menaxhohet dhe zyrtari duhet të veproj sipas nenit 17 të Ligjit nr.6/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në të cilin shprehimisht thuhet:

1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.
4. Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, institucioni punëdhënës regjistron identitetin e zyrtarit, interesat private të tij, shkak për një konflikt interesi dhe konfliktin apo papajtueshmërinë e konstatuar, palët e interesuara, burimin e informatave, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.
5. Deklaratat për interesat private dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë konsiderohen dokumente zyrtare.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

